



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 15.02.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 14.02.2019 të parashtruar nga OE **N.SH. " Viva Print " nga Gjilani**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve - faza e II-te 2018**, me Nr. të Prok: **616-18-9574-5-2-1** dhe numër te brendshëm **616 18 131 521** nxjerr:

### V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e OE **N.SH. " Viva Print " nga Gjilani** të dt. 14.02.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve - faza e II-te 2018"**, me Nr. të Prok: **616-18-9574-5-2-1** dhe numër te brendshëm **616 18 131 521**, kundër *Njoftimit për tenderuesin e eliminuar*, të datës 13.02.2019.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit per tenderin Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve - faza e II-te 2018"*, me Nr. të Prok: **616-18-9574-5-2-1** dhe numër te brendshëm **616 18 131 521**, sipas rregullave te LPP dhe rregullave dhe Udhezuesit per Prokurim Publik.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

**OE: N.SH. " Viva Print " nga Gjilani** me datë 14.02.2019, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve - faza e II-te 2018"**, me Nr. të Prok: **616-18-9574-5-2-1** dhe numër te brendshëm **616 18 131 521**. Autoriteti Kontraktues, me datë 15.02.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues ju njofton se me daten 06.02.2019 ju ka derguar letren standarde per tenderet jo normalishte te ulet si dhe kerkesen per dergimin e deshmive te kerkesave te pershtatshmerise siç jane:

1. Sigurimi I tenderit – origjinali
2. Vërtetimin nga ATK-ja – origjinali dhe
3. Vërtetimin nga Gjykata Ekonomike – origjinali.

Ju me datën 11.02.2019 i keni dërguar dokumentet e kërkuara nga AK. Vërtetimi qe ju keni dërguar ne AK – vërtetimi tatimor i ATK-se shkruan: Personi është i regjistruar në ATK dhe aktualisht është ne marrëveshje per te shlyer borxhet tatimore te mbetura.

AK gjate verifikimit te këtij dokumenti – vërtetimi tatimor përmes linkut: <https://vertetimi.atk-ks.org> ka konstatuar se vërtetimi tatimor qe ju keni dërguan ne AK rezulton se është i falsifikuar per arsye se ne vërtetimin e njëjte te datës se njëjte shkruan: Personi është përgjegjës ne ATK dhe ka borxhe tatimore apo obligime tjera tatimore te pashlyera.

AK – komisioni i vleresimit, ka bere vleresimin e ofertave gjithnje duke u mbeshtetur ne LPP dhe ne Rregullat e Udhezuesit Operativ per prokurim Publik.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit